Mire Mladenovski

Luftërat Ballkanike

Luftë për çlirim apo pushtim?

Pyetja kyçe

- A ishin Luftërat Ballkanike lufta për çlirim apo pushtim?

Çështje të tjera me të cilat do të merret moduli:
1. Cila është kronologjia e ngjarjeve?
2. Cilat ishin pritjet dhe arsyetimet e luftërave ballkanike?
3. Si perceptoheshin luftërat?
4. Cilat ishin pasojat e luftërave ballkanike?

Tema
Tema është për Luftërat Ballkanike (1912-1913). Kujdes i veçantë i është kushtuar rolit të atyre që janë përfshirë në luftë, me theks të veçantë në pritjet dhe dëshpërimet.
Kjo temë është e ndjeshme dhe përfshinë shumë shtete ballkanike. Kjo temë është kontroverse për shkak të këndvështrimeve të ndryshme për këtë ngjarje historike, dhe gjithashtu çështje mjaft e ndjeshme në këtë hapësirë.
Çështja kryesore është nëse këto luftëra ishin luftëra për çlirim ose luftëra për pushtim?

Rezultatet e mësimit:
1. Nxënësit do të kenë mundësi t'i vendosin ngjarjet historike në korniza kohore.
2. Do të zhvillojnë aftësi për analizë të burimeve dhe do të zhvillojnë mendim kritik.
3. Do të bëjnë vlerësimin e ngjarjeve historike nëpërmjet qasjes multiperspektive.
4. Nxënësit do t'i njohin raportet mes shteteve dhe popujve në atë kohë, pritjet e tyre dhe dëshpërimet gjatë kohës së luftërave ballkanike. Gjithashtu do të kuptojnë si ndikojnë këto ngjarje në jetët e njerëzve.

Qëllimet:
- Përvetësimi i vështrimit të multiperspektivës për Luftërat Ballkanike nëpërmjet analizës së burimeve të shumëllojshme.
- Hapja e diskutimit për pritjet dhe dëshpërimet nga Luftërat Ballkanike.
- Familjarizimi me atmosferën politike gjatë Luftërave Ballkanike dhe përpjekja për t'i sqaruar reagimet kontroverse për ngjarjen.

90 minuta

Udhëzime për mësimdhënësin:

Aktiviteti 1
Punë në grupe – Secili grup pranon dokumente të njëjta për krijimin e shiritit të kohës.

Aktiviteti 2
Punë në grupe – Analiza e llojeve të ndryshme të burimeve dhe diskutim.

Aktiviteti 3
Punë në grupe – Shkrimi i artikullit gazetaresk.

Aktiviteti 4
Punë në grupe – Përzgjedhja dhe përcaktimi i dokumenteve dhe diskutimit në përpjeke për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Aktiviteti 1

Secili grup (janë 4 ose 5 grupe) pranon dokumente të njëjta për të krijuar shiritin e kohës.

Çka është kronologjia e Luftërave Ballkanike?
Detyra e nxënësve është që në mënyrë kronologjike t'i rendisin gjashtë ngjarjet e rëndësishme për luftërat ballkanike. Secila ngjarje duhet të përfshijë datën, titullin, dokument të shkruar dhe burim vizual që i referohet.
Që të arrihet kjo, të gjitha burimet duhet të priten në copëza nga fletët e punës (faqe 185 dhe 186). Pas kësaj, ata duhet të renditen në letër të bardhë. Kjo do të krijojë shirit kohe për ngjarjet kryesore në Luftërat Ballkanike.
Kjo është punë në grupe dhe secili grup ka detyrë të njëjtë. Më pas secili grup do t'i prezantojë rezultatet e punës së tyre përballë të tjerëve.

TITULLI	Lidhja Ballkanike	Marrëveshja e Londrës	Marrëveshja e Bukureshtit	Lufta e Dytë Ballkanike	Lufta e Parë Ballkanike	Pavarësia e Shqipërisë
VITET	1912 - 1913	1912	1913	28. 11. 1912	30. 05. 1913	10 .08. 1913
TEKSTE	Lidhja Ballkanike është krijuar pas një serie të marrëveshjeve bilaterale mes shteteve ballkanike Bullgarisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë, ndërsa ishte drejtuar kundër Perandorisë Osmane, e cila në atë kohë kontrollonte pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik.		Në luftime morën pjesë Lidhja Ballkanike fitimtare (Serbia, Greqia, Mbretëria e Bullgarisë dhe Mali i Zi) dhe Perandoria Osmane humbëse. Fuqitë e mëdha i përfaqësonin Britania e Madhe, Gjermania, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia.		Bullgaria, Greqia, Mali i Zi dhe Serbia e sulmuan Perandorinë Osmane, duke e ndërprerë pushtetin e saj pesëshekullor në Ballkan gjatë luftimeve shtatë mujore që rezultoi me Marrëveshjen e Londrës.	
	Kuvendi prej tetëdhjetetre udhëheqësve popullorë u mbajt në Vlorë në nëntor të vitit 1912 dhe e shpalli Shqipërinë të pavarur dhe formoi qeveri të përkohshme. Në përputhje me nenin II të Marrëveshjes së Londrës, Shqipëria u pranua si shtet autonom nën sovranitetin e sulltanit osman.		Bullgaria ishte e pakënaqur me ndarjen e përfitimeve të luftës në Maqedoni. Ushtritë iu kundërvunë ofensivës bullgare dhe kundërsulmuan duke u futur në Bullgari, përderisa Rumania dhe Perandoria Osmane shfrytëzuan mundësinë për të intervenuar kundër Bullgarisë dhe për të bërë përfitime territoriale. Në Marrëveshjen e Bukureshtit, Bullgaria e humbi shumicën e territoreve që i kishte fituar në Luftën e Parë Ballkanike.		Bullgaria u mund nga forcat e kombinuara të Serbisë, Greqisë dhe Rumanisë. Në lidhje me vendimet e marrëveshjes, Bullgaria morri një pjesë të vogël të Maqedonisë dhe një rrip të bregdetit në Egje duke e përfshirë edhe portin Dedeağaç (Alexandroúpolis). Serbia e morri pjesën veriore dhe qendrore të Maqedonisë. Greqia e fitoi pjesën jugore të Maqedonisë, ndërsa Rumanisë iu dha Dobruxha jugore.	
FOTO-GRAFI	*http://en.wikipedia.org/wiki/File:London_Peace_Treaty_Signing_30_May_1913.jpg*			*http://en.wikipedia.org/wiki/File:28nentor.jpg*		

PLLAKATE



http://simple.wikipedia.org/wiki/File:Balkan_League_poster.png

http://www.robinsonlibrary.com/history/balkan/history/war1912.htm#.UyWrqWBX4lM

VIZATIME KARIKATUR ASH



Teaching modern southeast europian history, Alternative education material, The Balkan Wars, 2009, p.106


Si pubblica a Milano ogni Domenica
Supplemento illustrato del "Corriere della Sera"
Anno XIV. — Num. 52. 29 Dicembre 1912 - 5 Gennaio 1913. Centesimi 10 il numero.

Conferenza per la pace fra la Turchia e gli Stati Balcanici a Londra: i delegati turchi si ritirano per non trattare coi greci.
(Disegno di A. Beltrame).

Aktiviteti 2

Sqaroji pritjet nga lufta!

Dokumente për grupin I

Cilat janë arsyetimet dhe pritjet e Luftërave Ballkanike?
Detyra është të hulumtohen dokumentet, të gjenden arsyet e luftës (arsyetimet dhe pritjet). Pas kësaj, secili grup duhet t'i sqarojë (përballë grupeve të tjera) arsyetimet e luftës. I ndjekur me diskutim!

Grupi I punon me harta dhe statistika
Grupi II punon me karikatura
Grupi III punon me dokumente zyrtare
Grupi IV punon me dokumente jozyrtare

Burimi **1**

STATISTIKA zyrtare të popullsisë së Maqedonisë sipas shteteve

	BULLGARE (Kantchev, 1900)	SERBE (Gopçeviq, 1889)	GREKE (Delyani, 1904)
Turq	499 204	231 400	634 017
Bullgarë	1 181 336	57 600	332 162
Grekë	228 702	201 140	652 795
Shqiptarë	128 711	165 620	– –
Vlleh	80 767	69 665	25 101
Hebrenj	67 840	64 645	53 147
Romë	54 557	28 730	8 911
Serbë	700	2 048 320	– –
Të përzier	16 407	3 500	18 685
GJITHSEJTË	2 258 224	2 870 620	1 724 818

Tabela është krijuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga "Teaching modern southeast europian history, Alternative education material, The Balkan Wars", 2009

Burimi **2**

Aspiratat e vendeve ballkanike, duke iu referuar komisionit të Karnegit

[redacted]

http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Territorial_aspirations_of_the_Balkan_states,_1912.jpg (19.07.2013)

Burimi **3**

Harta etnike e Maqedonisë, në bazë të këndvështrimit serb

SLLAVË
Serbo-Kroatë
Aranutë (Serbë që flasin shqip)
Bullgarë
Sllavë maqedonas

Shqiptarë
Grekë
Vlleh
Turq

http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Macedonia_-_Point_of_View_of_the_Serbs.jpg (19.07.2013)

Burimi **4**

Harta etnike e Maqedonisë, në bazë zë këndvështrimit bullgar

Bullgarë
Rusianë
Shqiptarë

Vlleh
Grekë
Turq

http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Macedonia_-_Point_of_View_of_the_Bulgarians.jpg (19.07.2013)



Burimi **1**

Udhëtim argëtues!

Më jepni bileta qarkulluese për Sofje, Beograd, Cetinë dhe Athinë; me opsion kthyese.

-Sa bileta ju lutem?
-700.000 ose 800.000 për momentin.

Tobias Heinzelmann, Balkanska kriza u osmanliskim karikaturama. Satiricne novine Karagjoz i Kalem 1908-1914, Istanbul, 1999

Burimi **2**

Karikaturë shqiptare



Gazeta "Dielli", 13.02.1913, fq. 3

Burimi **3**

Maqedonia, Liria më në fund
Ilustrimi: Maqedonia, Liria më në fund



Punch or the London charivari, November, 27 1912

Burimi **4**

Karikaturë sllovene



Burimi **5**

Karikaturë bullgare

Dëbimi i osmanëve nga Evropa



Burimi **1**

KUSHTET E MARRËVESHJES SË ALEANCËS BALLKANIKE

Ekzistojnë dy pjesë të marrëveshjes bullgaro – serbe. Njëra pjesë krijoi lidhje mbrojtëse mes vendeve nënshkruese, në të cilin të dyja palët u obliguan ta "ndihmojnë njëra tjetrën me të gjitha forcat e tyre në rast se njëra prej tyre sulmohet nga ana e një ose më shumë vendeve". Pjesa tjetër është aneksi i fshehtë, në të cilin përgatiteshin për luftë të mundshme me Turqinë, në rast të problemeve të brendshme ose të jashtme të Turqisë, të cilat do të mundnin t'i kërcënojnë interesat nacionale të cilësdo qoftë prej nënshkrueseve, ose i kërcënohen prishjes së status kuosë në Gadishullin Ballkanik. Pjesë e rëndësishme e këtij aneksi të fshehtë është marrëveshja për ndarjen e territorit në rast të fitores në një luftë të tillë. Të gjitha hapësirat do të ishin nën kontroll të përbashkët përderisa nuk vjen deri te nënshkrimi i paqes. (...) Nëse megjithatë të dyja palët do të merreshin vesh që autonomia për këtë regjion nuk është e realizueshme, hapësira do të duhet të ndahet mes tyre sipas linjave të përcaktuara në marrëveshje, me përjashtim të zonës qendrore, e cila është lënë e pandarë, do të ndahen në arbitrazh nën udhëheqjen e perandorit rus. Aranzhimet territoriale paraqesin përpjekje për t'u kënaqur dëshirat serbe për ndarje dhe dalje në Detin Adriatik dhe plani bullgar për autonomi të Maqedonisë. Në fund, marrëveshja parashihte që perandori të jetë arbitër në çështjet tjera të cilat mund të dalin nga marrëveshja.

Anderson, Frank Maloy and Amos Shartle Hershey, Handbook for the Diplomatic History of Europe, Asia, and Africa 1870-1914. Prepared for the National Board for Historical Service. Government Printing Office, Washington, 1918.

Burimi **2**

Shpallje nga Gjergji I

5 tetor 1912, POPULLIT TIM
Obligimi ynë i shenjtë ndaj atdheut tonë të shenjtë, vëllezërve tanë të robëruar dhe njerëzimit, kërkon që shteti, pas dështimit të përpjekjeve paqësore të rruhen të drejtat e njeriut të të krishterëve nën turqit, të merren armët në dorë që të ndërpriten vuajtjet të cilat zgjasin me shekuj. Greqia, bashkë me aleatët e saj të cilët janë të inspiruar me ndjenjat e njëjta dhe të lidhur me obligimet e njëjta, hyjnë në betejë të shenjë për drejtësi dhe liri të popujve të nënshtruar të orientit. Ushtria dhe flota detare, plotësisht të vetëdijshme për detyrën e tyre ndaj popullit dhe krishterimit, traditave të tyre dhe krenare për superioritetin e tyre moral dhe vlerat, ndershmërisht hyjnë në luftë të gatshëm ta derdhin gjakun e tyre të ndershëm që të nënshtruarve t'ua kthejnë lirinë. Greqia, bashkë me aleatët, do të shkojë drejt qëllimit me çdo çmim; duke iu drejtuar ndihmës së Zotit në këtë luftë plotësisht të arsyeshme të qytetërimit, brohorisim – Rroftë Greqia, rroftë populli ynë.

Gardika-Katsiadaki, G. Margaritis, The Aegean in Balkan wars, Atina, 2002

Burimi **3**

Manifest për popullin bullgar, 5 tetor 1912

Ndjenjat njerëzore, të krishtera, obligimi i shenjtë t'u ndihmoni vëllezërve tuaj kur rrezikohet ekzistenca e tyre kryesore, në emër të nderit dhe dinjitetit të Bullgarisë, më detyrojnë që t'i thirri nën flamur bijtë e këtij vendi të cilët janë të gatshëm ta mbrojnë. Qëllimi ynë është i drejtë, i shenjtë dhe i lavdishëm. Me besim në mbrojtjen dhe ndihmën e Zotit të gjithëfuqishëm, i shpall popullit bullgar se është shpallur lufta për të drejtat e njeriut të të krishterëve në Turqi.
I urdhëroj ushtrisë së guximshme bullgare që ta sulmojë territorin e Turqisë! Bashkë me ne, në qëllim të përbashkët, kundër armikut të përbashkët do të luftojnë edhe ushtritë e aleatëve tanë, shtetet ballkanike – Serbia, Greqia dhe Mali i Zi. Edhe në këtë luftë të Kryqit dhe Gjysmëhënës, respektivisht lirisë kundër tiranisë, në anën tonë do t'i kemi të gjithë njerëzit të cilët e duan drejtësinë dhe përparimin.

П.К , Б
. 1912-1913, C 1999

Burimi **4**

SHPALLJA E LUFTËS

Serbë të mi të dashur,
Ndodhi ajo që asnjëherë nuk kam shpresuar. Bullgarët, vëllezërit tanë të gjakut dhe fesë, aleatët tanë, filluan luftë të pashpallur ndaj nesh. E derdhën gjakun e vëllezërve të tyre, aleatëve të tyre dhe në mënyrë jonjerëzore i vranë të plagosurit. E prenë me shpatë marrëveshjen e aleancës dhe e zhdukën miqësinë dhe vëllazërinë. Dhe ja, tanimë tetë ditë që në Ovçe Pole, në Maqedoni, në kufijtë e vjetër të atdheut tonë, zhvillohet betejë e ashpër dhe derdhet gjaku vëllazëror.
(...) Bullgarët e harruan ndihmën serbe dhe vëllazërore, e harruan gjakun e derdhur dhe heronjtë e rënë në fushat e Trakisë! Sllavizmit dhe botës së kulturuar i ofruan shembull të mbrapshtë të mosmirënjohjes dhe lakmisë. Veprimi jovëllazëror i sulmuesve bullgarë Mua më lëndoi thellë. Ai i lëndoi ndjenjat e mia të sinqerta sllave. Përgjegjësinë për këtë krim ndaj sllavizmit dhe njerëzimit le ta mbajë ai i cili e ka kryer. Dhe për çka? Sepse nuk duan që në mënyrë vëllazërore, të qetë të diskutohet kontesti për ndarjen!
(...) Ushtarëve të Mi të dashur le t'u del në ndihmë Zoti dhe fati i trimërisë, në këtë luftë të pikëlluar, por të imponuar ndaj nesh.

Beograd, 25 qershor 1913. Mbreti Petar I (nënshkruar)

Burimi **5**

Proklamimi i mbretit Nikolla të Malit të Zi

Malazezë!
(...) Të tronditur nga fitoret e arritura dhe lavdinë e aleatëve tanë, parteri ynë i katërt dëshironte që me forcë t'i marrë sukseset tona të përbashkëta, duke mos e respektuar drejtësinë e Zotit dhe gjykimin prindëror të perandorit mbrojtës.
(...) Bullgarët, të joshur, u shkëputën nga kopeja jonë sllave (...) i sulmuan vëllezërit dhe aleatët tanë. Bullgarët duhet të pengohen që të përdorin armën e njëjtë dhe të udhëzohen t'i respektojnë interesat e përbashkëta të solidaritetit sllav. Këtë vendim e kam të vështirë, sepse i bie që ta pres dorën me dorë, por ndryshe nuk kishim mundësi të veprojmë. Shpirtin ma ka kapluar pikëllimi sepse duhet ta inkurajoj guximin tuaj që me forcë t'i sprapsni sulmet bullgare, por shpresa më mban që një ditë, kur engjëlli i paqes t'i hapë flatrat mbi Ballkan, të rritet druri i ri, i freskët i bashkimit sllav nga përzierja e gjakut tonë sllav (...).

Nikolla (nënshkruar), Në Cetinë, 27 korrik 1913

Balkanski rat u slici i reči 23, 14 (27) July 1913.

Burimi **1**

Vendime lidhur me qëndrimin që duhej të mbanin shqiptarët me rastin e shpërthimit të luftës së parë ballkanike, Shkup, 14 tetor 1912

Dega e Komitetit "Shpëtimi" në Shkup, bashkë me atë të "Shoqërisë së Zezë" mbajtën mbledhje të jashtëzakonshme me këtë rend dite:
Turqia do ta sjell luftën. Pra, si të shpëtohet Shqipëria?
U morën vendimet:
1. Me iu dërgua një proklamatë Fuqive të Mëdha;
2. Me u caktua një delegacion për me i shkëput Malet e Shkodrës nga aleanca që kishin bërë me Malin e Zi;
3. Ky delegacion do të ketë edhe një kompetencë të plotë për t'u marr vesh me krahinat e tjera të Shqipërisë dhe me e shpëtuar Shqipërinë nga rreziku i copëtimit.
Proklamata që u dha më 16.10.1912 me vulë të "Shoqërisë së Zezë" përmbante në disa reshta këtë: "Shoqëria e Zezë", përfaqësuese e popullit shqiptar, ka nderi me ju lajmëruar që Shqipëria i ka kapur armët jo për ta forcuar dominimin e Turqisë në Ballkan, por për t'i dalë zot tërësisë tokësore dhe lirisë së Shqipërisë. Pra, që sot po Ju deklarojmë se sido që të jetë fati i armëve, shqiptarët nuk kanë me pranuar për katër vilajetet veçse një formë politike e një formë sundimi.

Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, pp. 255-256.

Burimi **2**

Hristo Kabakçiev* për aspiratat e bullgare ndaj Maqedonisë

...Natyrisht, Maqedonia ishte një vend drejt të cilit ishin drejtuar të gjitha dëshirat dhe simpatitë e borgjezisë bullgare. Që nga ajo kohë borgjezia nuk mund të ndahej nga opsesioni i "çlirimit" të Maqedonisë. Në të kundërtën, sa më shumë që zhvillohej kapitalizmi, aq më e madhe është dëshira patriotike për Maqedoninë...

**Aktivist i dalluar i lëvizjes punëtore bullgare dhe ndërkombëtare*

Д , C 1985, . 543

Burimi **3**

Qëndrimi i Dimitrije Tucoviqit ndaj pushtuesve ballkanikë të Maqedonisë, në vitin 1913

...Ne, social-demokratët, sipas kësaj, nuk mund të pyesim kujt t'i takojë Maqedonia, sepse nuk mund të pajtohemi ta shohim t'i takojë qoftë Serbisë, Bullgarisë ose Greqisë, e as të ndahet mes shteteve... I vetmi qëndrim i drejtë të cilin ne, social-demokratët e përkrahim është: liria, jo shtypja, barazia e jo nënshtrimi, për të gjithë popujt. E tërë kjo mund të arrihet jo me pushtimin e Maqedonisë nga ana e Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë, dhe ndarjen mes tyre, por me lirinë e plotë të popullsisë maqedonase, të konstituuar kombëtarisht si anëtar i barabartë për t'u futur në federatën ballkanike. Normalisht, e njëjta vlen për Trakinë dhe Shqipërinë.

Istorijski arhiv Beograda, CPY Vol 3 1950, str. 239-242.

Burimi **4**

Memorandumi i pavarësisë së Maqedonisë i pranuar nga kolonia maqedonase në Shën Pjetërburg, në Konferencën e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Londër

...Tani Maqedonia është çliruar sërish. Por Evropa është e prirë ta bëjë gabimin e njëjtë që e ka bërë në vitin 1878. Në vend që ta proklamojë Maqedoninë si shtet autonom, çlirimtarët e saj të ri kanë vendosur ta ndajnë mes veti; ne jemi të bindur dhe thellësisht besojmë se qarqet e vetëdijshme dhe demokratike të popullit bullgar, grek dhe serb nuk kanë marrë pjesë në këtë ndarje të popullit Maqedonas. Megjithatë, Maqedonia i ka të gjitha të drejtat e natyrshme dhe historike për vetëvendosje. Gjatë shekujve ka qenë njësi autonome politike ose është përfshirë në strukturat e shteteve të tjera. Kjo ka rezultuar nga pozita e saj gjeografike dhe individualiteti. Kufijtë e Maqedonisë janë të shënuar qartë nga zinxhirët e maleve që e rrethojnë atë dhe nga bregdeti. Kjo tërësi gjeografike dhe i tërë sistemi i luginave dhe fushave pjellore të veshura për mrekulli gjithashtu e përcaktojnë tërësinë ekonomike e shfaqjen e vendit...

Д , C 1985, . 554

Aktiviteti 3

Shkruaj dokument për Luftërat Ballkanike!

Dokumente për grupin I

Si u perceptuan luftërat?

Fillohet me stuhi idesh të shkurtër të lidhur me temën "LUFTA". Në tabelë shkruhen 10-15 fjalë të cilat dalin nga stuhia e ideve. Secili grup pastaj me rrol të caktuar. Rolet e mundshme janë si në vijim (secili mësimdhënës i përzgjedh rolet i pavarur):
Grupi I – Ushtari i cili i shkruan letër familjes, ose jep intervista për gazetat.
Grupi II – Civil i cili i shkruan letër familjes, ose jep intervistë për gazetat.
Grupi III – Gazetar i cili shkruan artikull për luftërat ballkanike.
Grupi IV – Gazetar i cili shkruan për çështjen shqiptare ose për çështjen maqedonase gjatë luftërave ballkanike.
Detyra e secilit grup është që të përgatiten dokumentet e shkruara (letër, artikull, raport ose intervistë, varësisht nga grupi). Në ato dokumente duket të përdoren të gjitha 10-15 fjalë që dalin nga stuhitë e ideve të përbashkëta në temën "LUFTA".

Burimi **1**

Pritjet e ushtarit serb

Ushtari serb, si ai grek, ishte i bindur fuqishëm që në Maqedoni do t'i gjejë bashkëkombësit e vet, njerëz që flasin me gjuhën e tij dhe të cilët do t'i thërrasin "zhiveo" ose "zito". Gjetën njerëz zë cilët flisnin gjuhë të ndryshme nga gjuha e tyre, dhe thirrën "ura"! Gabimisht e kuptuan, ose aspak nuk e kuptuan. Teorinë të cilën e mësuan për ekzistimin e Maqedonisë serbe dhe Maqedoninë greke, normalisht, u luhatën, por bindjet e tyre patriotike, që Maqedonia patjetër të bëhet serbe ose greke, nëse tanimë nuk është, mbeti e paprekur. Padyshim, Maqedonia ishte ajo që dëshironin sërish të bëhet, në kohën e Dukës së Fuqishëm ose të perandorëve bizantinë. Agjitatorët dhe propaganduesit, bullgarët, të cilët ia futën në kokë popullsisë idenë që janë bullgarë. Agjitatorët duhet të dëbohen nga vendi, dhe atëherë do të jetë siç ka qenë çdoherë, do të jetë serbe ose greke. Ata edhe vepronin në këto baza. Kush ishin ata agjitatorë të cilët i detyronin njerëzit ta harrojnë gjuhën greke dhe serbe? Së pari ata ishin priftërinjtë; pastaj drejtorët e shkollave; dhe në fund elementët revolucionarë, të cilët nën regjimin e vjetër formuan organizatë; udhëheqës të bandave dhe anëtarëve të tyre, fshatarë të cilët u jepnin para dhe ushqim, shkurtimisht, të gjithë meshkujt, nëse ishin të shkolluar dhe të informuar.

Carnegie Endowment for International Peace, Report of the International Commission... , str.50-51.

Burimi **2**

Më 21 qershor gjatë betejës u plagosa me një grimcë në këmbën e majtë dhe në shputë. I pafuqishëm që të lëviz, isha i detyruar që të qëndroj ku isha. Disa ushtarë bullgarë erdhën, ndërsa dy filluan të më plaçkitin. Ma morën pallton e lëkurës me 115 franga, qesen e lëkurës (kuletën), mbajtësen e cigares nga qelibari, epoletat, fishkëllyesen, kutinë e shkrepëses, kapelën dhe kokardën. Kur i morën të gjitha këto, ishin të gatshëm të shkonin, por njëri prej tyre tha: "Hajde ta vrasim!" Atëherë e mprehu thikën në pushkë dhe bëri tre prerje të thella, dy në anën e majtë, ndërsa një në të djathtën. Tjetri më shqelmoi fuqishëm në këmbë dhe brinjët e anës së djathtë. Bullgari i tretë u afrua dhe më goditi me musketën e tij. Pastaj shkuan.

Carnegie Endowment for International Peace, Report of the International Commission... , str.61.

Burimi **3**

Morali në ushtrinë bullgare, analizuar nga shefi i shtabit bullgar, disa vite pas luftës

Morali i ushtrisë sonë aspak nuk ishte i lartë. Duke pasur mungesa të shumta dhe sëmundje gjatë kohë, ushtria jonë ishte në depresion. Bisedimet e gjata shkaktonin nervozë mes ushtarëve. Të gjithë kishin dëshirë të shkojnë në shtëpi sa më parë të ishte e mundur. Përveç kësaj, ideja për luftën e mundshme kundër aleatëve, nuk ishte aspak e popullarizuar mes ushtarëve, dhe përpiqeshin që këtë mundësi ta anashkalojnë.
Oficerët vazhdimisht e fshihnin faktin që kishte pasur demonstrata dhe trazira kundër luftës në radhët e ushtrisë, për çka zëvendësi i shefit të shtabit të përgjithshëm i kishte kërcënuar se do të përjashtohen për shkak të lejimit të parregullsive. Kështu, askush nuk kishte mundësi ta thotë të vërtetën. Kuptohet, kishte një propagandë defetistësh të elementeve ekstreme, por kjo nuk ishte e rrezikshme si kur te secili ushtar ekziston bindje e brendshme që një luftë e tillë vëllavrasëse nuk do të sjellë asgjë të mirë. Tërmetet në Veliko Turnovo dhe Gorna Orahovishta gjithashtu kontribuuan për depresionin.

Teaching modern southeast europian history, Alternative education material, The "Balkan Wars", 2009, str. 79

Burimi **4**

Pjesë nga letra e ushtarit grek, të zënë rob nga ana e bullgarëve në regjionin e Razllogut.

Rodope, 11.07.1913
Kjo luftë është shumë e dhembshme. I dogjëm të gjitha fshatrat të cilët i lëshuan bullgarët. Ata i dogjën fshatrat greke, ndërsa ne ato bullgare. Ata na masakrojnë neve, ndërsa ne ata, ndërsa kundër të gjithë atyre të që nga ky komb i rrejshëm që bien në duart tona, Mannlicheri e bën të vetën. Prej 1.200 të zënëve rob të cilët i kapëm në Nigrita, vetëm 41 mbetën në burg, dhe çdo kund ku kaluam, nuk lamë asnjë gjurmë të kësaj race..

Teaching modern southeast europian history, Alternative education material, The Balkan Wars, 2009,

Burimi **5**

Letër e Ipokratis Papavasiliusit drejtuar gruas të tij Aleksandra Sneftsi, 23 qershor 1913

Gruaja ime e dashur,
Gjatë luftimeve me turqit të kam shkruar nga fshatrat turk. Tani, gjatë luftimeve me bullgarët, të shkruaj nga vendet bullgare. Të shkrova parmbrëmë, e dashur, menjëherë pas betejës në Kiklis – fitores tonë të madhe. Kiklis ishte qytet i shenjtë për bullgarët dhe komitët guerilë, si dhe vendlindja e Danefit. Pas betejës, e dogjën qytetin. Ky ishte një spektakël i madh; u dogj dy ditë; njerëzit, të gjithë bullgarë, e lëshuan para kësaj. Ushtria jonë, e dashur, përparon me hapa të shpejtë, duke i detyruar bullgarët që të ndihen si lepuj të përndjekur. Vrapojnë tepër shpejtë për ne, por ne do t'i arrijmë, njëherë duhet të ndalen diku. E dashur, nuk mundesh as ta paramendosh pamjen që e paraqet kjo luftë. Çdo kund ku shkojmë hasim shkretim dhe mizori; turqit, të cilët siç duket vuajtën shumë nën bullgarët, tani hakmerren duke i djegur fshatrat dhe pronën e tyre. Çdoherë duket një fshat në flakë. Bullgarët ikën; nuk ka më bullgarë në Maqedoni; bishat ikën përgjithmonë; do të duhej t'i shohësh çfarë frikacakësh janë: të zënët robër dridhen nga frika. Jam i lumtur që kjo luftë njëherë e përgjithmonë e zgjidhi çështjen e këtyre abuzuesve, që na detyroi ta njohim njëri tjetrin, që na mundësoi t'i mënjanojmë lëkurat e tyre të luanëve dhe t'i demaskojmë, sepse sjellja e tyre e paturpshme e kishte mashtruar botën e cila i quajti "Prusët e Lindjes", këta njerëz qesharakë e budallenj. Të pakënaqur me atë që tanimë e kishin, ata hiena të konvertuara, dëshironin të grabisin edhe pjesë nga aleatët e tyre, prej atyre që u ndihmuan në pushtimet e tyre dhe pa të cilët moti do të kishin dështuar nën turqit. Tani do të humbin çdo gjë që kishim. Kështu e kërkojnë. Ata janë shembull i gjallë i rrëfimit mitik për qenin dhe mishin.
E ndjej që çdoherë jeni pranë meje, ti dhe fëmijët tanë të dashur. Unë digjem për ty, por fitorja është ngushëllim, se kjo do të thotë se ndarja jonë nuk do të zgjatë shumë. Mendoj se lufta nuk do të zgjas më gjatë se dy javë që nga ky moment.
Çka mund të thotë Evgenios tani për bullgarët, të cilët i admironte aq shumë?

Me gjithë dashurinë time, burri i juaj Triças, fq. 318-319

Burimi **6**

Gjenerali bullgar për sigurinë e jetës, pronës dhe nderit të popullsisë në territoret e çliruara

Lozengrad, 13 dhjetor 1912
Disa informata erdhën deri te shtabi, të cilat për fat të keq, bëjnë që të dyshojmë që disa njerëz dhe oficerë kanë plaçkitur dhe kanë ushtruar dhunë ndaj civilëve, në territoret e pushtuara. Duke e pasur parasysh që në njërën anë, veprimet e tilla të dënueshme dhe johumane e komprometojnë popullin bullgar, ndërsa nga ana tjetër e luhatin besimin e të nënshtruarve tanë të mundshëm, veçanërisht në mesin e popullsisë civile myslimane, në aftësinë e vendit tonë që ta sigurojë nderin e tyre, pronën dhe jetën, urdhëroj:
1. Komandantët dhe udhëheqësit ushtarakë (guvernatorët) duhet të ndërmarrin masa të shpejta dhe të ashpra, që ngrisin procesuimin e veprave të tilla të kryera në hapësirën të cilët e kanë okupuar njësitë e tyre; fajtorët duhet të nxirren menjëherë para gjyqit, pa e pasur parasysh aktin dhe pozitën e tyre. Të gjithë komandantët duhet të paralajmërohen t'i dënojnë aktet e tilla kriminale pa mëshirë, duke e pasur në mendje përgjegjësinë të cilën do ta mbajnë në rast të kundërt.
2. Masa të ashpra duhet të ndërmerren që në prapavijë të vendoset rendi dhe disiplina. Të gjithë ata të cilët nuk janë pjesë e ushtrisë ose nuk punojnë për ushtrinë, duhet të kthehen prapa në Bullgari. Të gjithë ata të cilët janë në ushtri, por që për shkak të pasigurisë së tyre mund ta komprometojnë shërbimin në prapavijë, duhet të dërgohen në vijën e frontit.
3. Të gjitha gradat duhet të paralajmërohen që popullsia civile e territoreve të okupuara, pa e marrë parasysh nacionalitetin dhe fenë e tyre, është nën mbrojtjen e ligjeve tona të luftës, dhe secila dhunë e paarsyeshme mbi to do të procedohet sipas po atyre ligjeve. Që të kemi sukses në këtë, u bëj thirrje të gjithë përfaqësuesve ushtarakë dhe civilë të pushtetit të bashkëpunojnë.
4. Në fund, do të doja të ju përkujtoj se luftën e fituam në emër të ideve të larta humane, d.m.th t'i çlirojmë këta njerëz nga regjimi, i cili u bë i padurueshëm për nga dhuna dhe padrejtësia e tij. Zot, ndihmoju bijve të tu të guximshëm bullgarë në arritjen e këtij qëllimi madhështor. Në këtë moment u apeloj të gjithëve që të mos t'u lejojnë bashkëluftëtarëve që me veprimet e tilla ta komprometojnë arritjen e tyre të madhe dhe të lavdishme para syve të botës së qytetëruar".

Г -С . Т ., И , , С , 1996

Burimi **1**

DËSHMIA E RAHNI EFENDIUT *nga Strumica*

...U formua xhandarmeria lokale, ndërsa nga një xhandar dhe ushtar u dërguan të shkojnë shtëpi më shtëpi, dhe t'i thërrasin myslimanët, një nga një, para komisionit. Edhe un u thirra me të tjerët.
Procedura ishte si në vijim: komandanti serb pyeste "Çfarë njeriu është ky?" Përgjigja ishte thjeshtë "i mirë" ose "i keq". Nuk parashtronin pyetje për karakterin tonë; nuk kishte mbrojtje e as diskutim; nëse njëri anëtar i komisionit do të thoshte "i keq" kjo do të ishte e mjaftueshme që ta dënojnë individin me burg. Secili anëtar i komisionit i kishte armiqtë e tij të cilët dëshironte t'i shkatërrojë, dhe askush nuk i kundërshtonte mendimet e anëtarëve të tjerë të komisionit. Pas shqiptimit të gjykimit i burgosuri i nxirrte teshat e tij, ndërsa paratë i merrte komandanti serb. Unë u shpalla "i mirë", bashkë me ndoshta edhe nja dhjetë të tjerë të arrestuar. Ata të cilët u gjykuan, u lidhën bashkë nga tre dhe u dërguan në thertore; veshët dhe hundët e tyre shpesh u priteshin para se të vriten. Therja zgjati një muaj; besoj se në qytet dhe në fshatrat e afërt u vranë mes tre dhe katër mijë myslimanë".
ABDYL KERIN AGA *nga Strumica*, i vërtetoi deklaratat e dëshmitarit të mëparshëm. Djali i tij është lidhur në derën e shtëpisë së tij; ai atëherë shkoi deri te Toma, udhëheqësi i bandave bullgare dhe u përpoq që të merret vesh me ata për jetën e djalit të tij. Toma kërkonte 100 funta; ai tanimë paraprakisht dy herë kishte paguar 50 dhe 70 funta, që ta shpëtojë djalin e tij. I tha Tomait që nuk ka të gatshme aq para, por që të do të përpiqet ta shesë shitoren, nëse bullgarët do të presin deri në mbrëmje. Toma refuzoi të presë dhe djalin e tij e vranë.

Carnegie Endowment for International Peace, Report of the International Commission... , str 73

Burimi **2**

Thirrja e Karnegit për komente ndërkombëtare paqësore pas humbjeve të ndërsjella nga djegia e fshatrave dhe eksodi i njerëzve

Djegia e fshatrave dhe eksodi i popullsisë së nënshtruar është dukuri normale dhe tradicionale e të gjitha luftërave dhe kryengritjeve ballkanike. Kjo është shprehi e të gjithë këtyre popujve. Atë që vetë e kanë përjetuat, të njëjtën ua kthejnë të tjerëve. Kjo kishte mundësi të mënjanohet vetëm me urdhrat e domosdoshme nga Athina, Beogradi dhe Sofja, dhe atëherë vetëm me kushte që kisha dhe organizata kryengritëse do t'i kishin përkrahur vendimet e qeverisë. Thirrje të përgjithshme për humanizëm në fakt dërgoi organizata e brendshme kryengritëse maqedonase por si duket kishte shumë pak efekt.

Carnegie Endowment for International Peace, Report of the International Commission... , .73

Burimi **3**

Kujtimet e Martulkovit për takimin e parë të ushtrisë serbe dhe qytetarëve të qytetit të tij të lindjes Velesit, në vjeshtën e vitit 1912

Që në fillim, aleatët ballkanikë – "çlirimtarët" – shënuan fitore të mëdha kundër Turqisë. Kur ushtria serbe e mori qytetin tonë, Velesin, ne, qytetarët, i pritëm "çlirimtarët" në mënyrë mjaft solemne. Duhet të thuhet që në ditët e para të luftës pjesa më e madhe e banorëve – me disa përjashtime të vogla – ishin mjaft të gëzuar. Më në fund erdhi fundi i sundimit pesëshekullor turk! Ishim të mbushur me shpresë se do të vijnë kushte të volitshme për jetë dhe ripërtëritje më të mirë, duke i vënë pikë të kaluarës së vështirë dhe duke i mbrojtur interesat e popullit maqedonas.
Por, për fat të keq, që në fillim, kishte mundësi të shihet çfarë erërash fryjnë mes aleatëve 'çlirimtarë', dhe çfarë befasish mund të priten në të ardhmen e afërt... Çlirimtarët "tanë" nuk i fshihnin aspiratat e tyre serbomëdha. Kur fillonit të bisedoni

Burimi **1**

LUFTA NË BALLKAN – I

Evropa lakmitare dhe e kalbur për qindra vjet lejon që kopetë e egra turke egërsisht t'i torturojnë, vrasin dhe keqtrajtojnë të krishterët e pafajshëm, të cilët me fajin e Evropës së qytetëruar dhe të kulturuar i ka gjetur e keqja që i mban ende të robëruar krijesa e njëjtë fanatike fetare, që quhet turk.
Të tëra këto i duron, lejon Evropa gjoja e përparuar, kulturore, humanitare, sepse varësia e kësaj Evrope të kulturuar, pangopësia dhe grykësia, përndryshe përtaci dhe poshtërsi në këtë kohë "të qytetëruar", i ka penguar deri tani çdoherë të drejtëve, të cilët do të ishin ngritur në mbrojtje të të shtypurve dhe martirëve, t'i çlirojnë nga egërsira gjakpirëse. Kështu turku ende qetësisht në sytë e Evropës së kulturuar dhe humaniste theri, robëroi, dogji, keqtrajtoi gra, fëmijë dhe pleq të pafuqishëm. Nëse këta njerëz të keqtrajtuar në dëshpërim do të ishin ngritur dhe do të ishin përpjekur ta heqin nga vetja e tyre sundimin e egër të egërsirës otomane, menjëherë Evropa e kulturuar, i del në ndihmë bishës së egër për ta shtypur piskamën dëshpëruese dhe vajtimin e krishterëve të përvuajtur e të varfër. E tëra kjo në emër të qytetërimit të rrejshëm dhe të kulturuar të Evropës së përgjakur.

Gazeta ditore, NASA SLOGA, Pula, 17 tetor 1912

Burimi **2**

LUFTA NË BALLKAN – II

Vendet ballkanike gjithsesi që futen në luftë vetëm që t'i fitojnë ato premtimet e vogla për reforma nga Turqia, por edhe me shpresë për të fituar autonomi të plotë për provincat e krishtera, ose që t'i zgjerojnë territoret e tyre (...) Gjithsesi, suksesi përfundimtar i vendeve ballkanike varet nga gatishmëria e tyre për luftë dhe për mirëkuptim të ndërsjellë dhe zbatim të interesit të tyre të përbashkët. Nëse kjo është aleancë e mbështetur në themele solidariteti, suksesi i tyre është i garantuar: ai do të jetë në gjendje t'u kundërshtojë, si autoritet i ri, të gjitha ndikimeve të jashtme.

Obzor, gazetë ditore nga Zagrebi, 10 tetor 1912

Burimi **3**

Perspektiva sllovene për situatën në Maqedoni

...Asnjë popull sllav nuk mendon të hedh vaj në zjarr në këtë konflikt; bile edhe rusët, si vëllezër më të vjetër, shmangen që të përzihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në konflikt, si arbitra. "Ruskoje Slovo" (Fjala ruse) në mënyrë të hapur i paralajmëroi serbët – dhe në mënyrë eksplicite gjithashtu edhe bullgarët – që në rast të luftës nuk duhet të llogarisin në ndihmën e Rusisë e as të simpative të Antantës... Assesi nuk guxon të lejohet lufta e re ballkanike.
Fuqitë e Mëdha i kanë në dispozicion mjetet e nevojshme që t'u venë pikë kontesteve të çmendura dhe mospajtimeve të njërës dhe palës tjetër. Masë e këtillë është autonomia e Maqedonisë – është e qartë se masa e tillë do të merret vetëm në rast ekstrem, kur të gjitha mjetet tjera tregohen joefikase.
Qëndrimi i gazetave ruse nuk është asgjë e re në botë. Në rrethet e ngushta në Ballkan me muaj është e njohur që ekziston një palë – pak a shumë e rëndësishme – e cila dëshiron të krijojë Maqedoni autonome; ajo palë janë separatistët. Ata punojnë fshehurazi, ndërsa është e qartë pse. Por nëse e fitojnë përkrahjen e palës aq të fuqishme siç është Rusia, kjo do t'i inkurajonte, shpejtë do të fitojnë ndjekës të ri dhe ardhmëria do mund t'u buzëqeshë papritur.

List „Slovenec", 122, 31. maj 1913.

Burimi **4**

Pjesë artikulli nga gazeta bullgare, 26.07.1913 – NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PAQËSORE

Marrëveshja paqësore është nënshkruar në Bukuresh, por nuk do të ketë aspak paqe në Ballkan. Nuk mund të ketë paqe atje ku ka dhunë. Marrëveshja e nënshkruar në Bukuresht është miratimi i dhunës më brutale. Bullgaria asnjëherë nuk do të pajtohet me këtë. E zvogëluar, e ngushtuar në kufijtë e saj, e plaçkitur, e ngulfatur, e keqtrajtuar, do të fillojë të punojë brenda kufijve të saj që ta forcojë ekonominë e saj, forcën kulturore dhe fizike, t'i shumëzojë dhjetë herë, ashtu që sa të shfaqet momenti i përshtatshëm, Bullgaria do ta merr atë që i takon, sipas së drejtës nacionale dhe historike.

„H " [Narodna volja], 53, br. 58, 26. srpnja 1913., u: K , Б

Burimi **1**

Pjesë nga dy gazeta të botuara në gjuhën shqipe jashtë vendit, të cilat shprehin qëndrime të ndryshme për Luftën e Parë Ballkanike

A. NGA GAZETA E BOTUAR NË BOSTON

Mbledhja e madhe që e mbajtën patriotët në Boston më 6.10.1912 është shumë e rëndësishme në historinë e lëvizjes shqiptare. Mbledhjet tjera që janë mbajtur në Amerikë e shprehën patriotizmin dhe idealet e të rinjve tanë. Por mbledhja e 6 tetorit tregoi një gjë tjetër të papritur dhe të mrekullueshme, sepse është gjë e rrallë: Dëshiroj të flas për rëndësinë e saj politike. Nuk është e parëndësishme dukuria që patriotët u mblodhën nga të gjitha anët e Amerikës dhe njëzëri deklaruan që interesi i Shqipërisë është bashkimi i plotë me Turqinë kundër vendeve ballkanike. Shqipëria është në rrezik të ndahet dhe mund ta shpëtojnë vetëm miqtë dhe ata që e përkrahin. Ky takim ishte arsye që ndikoi, në masë të madhe, që qeveria otomane t'i mbrojë interesat e Shqipërisë gjatë Konferencës së Londrës. Nuk mund të mohohet që, nëse Turqia do të hiqte dorë nga mbrojtja e Shqipërisë, në interes të saj do të ishte që Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi t'u japë atë që kërkojnë dhe të lidh paqe me ta, dhe atëherë do të duhet të ballafaqohet vetëm me Bullgarinë. Por aksioni ynë i bashkuar e zbuti Turqinë, ndërsa politika jonë bëri që Turqia t'i shohë gabimet e saja dhe dëmin e bërë në të kaluarën, dhe dëshironte të na shpërblejë duke insistuar që Janina, Shkodra dhe, nëse është e mundur, Manastiri, të jenë pjesë e Shqipërisë së re.

„Dielli“ , 19. 12. 1912., f. 1.

B. GAZETA E BOTUAR NË SOFJE

Ky program i katër fuqive të bashkuara është i dëshirueshëm; prandaj shqiptarët nuk guxojnë të bashkohen me Turqinë dhe të luftojnë në anën e atij i cili është i dënuar me vdekje. Shqiptarët duhet ta ngritin zërin e tyre dhe t'i kërkojnë të drejtat e tyre nga fuqitë e mëdha. Duhet t'i tregojnë gjithë botës që populli shqiptar është robëruar dhe që tanimë 4 vite lufton dhe kërkon autonomi për Shqipërinë.

"Mbi Aleancën Ballkanike", Liri e Shqipërisë, 12 tetor 1912, f. 1.

Burimi **2**

Shkatërrimet e shkaktuara me luftimet në fshatrat e rrethit të Shkodrës dhe agonia e popullit i cili përpiqet ta gjejë arsyen për vuajtjen e vet.

Disa zona ishin aq të mëdha saqë më duheshin tre ditë dhe 10 deri në 12 orë udhëtim përreth që t'u ndihmoj dhe të kthehem në Shkodër. Përgjithësisht, vizitova 1.022 familje shtëpitë e të cilëve ishin djegur në rrethinën e Shkodrës. Gjëja më e pikëlluar në tërë këtë punë ishte që vetëm disa prej këtyre të pafatëve e kishin parasysh atë se pse ndodhi kjo e tëra. Gratë me fëmijët e uritur do të pyesnin: "Pse lejuan mbretërit e mëdhenj (fuqitë e mëdha) që ushtarët të vijnë dhe të na plaçkitin dhe të na vrasin? Ne nuk kemi bërë asgjë të keqe. Na i morën dhitë dhe dhentë tona – të gjitha, të gjitha i morën. Kur buri im u përpoq të shpëtojë një dele, e vranë. Shtëpia jonë është djegur. Kemi mbetur në rrugë të uritur.

M. Edith Durham, The struggle for Scutari, London p.296.

Burimi **3**

Telegram nga përfaqësuesi i qeverisë së përkohshme të Shqipërisë drejtuar ministrave të punëve të jashtme të Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë, 29 nëntor 1912.

Dëshiroj t'i informoj ekselencat Tuaja për një ngjarje të shquar në aspektin kombëtar të shqiptarëve. Përfaqësues nga të gjitha pjesët e Shqipërisë, të përkatësive të ndryshme fetare, u mblodhën dje në Vlorë në Kuvendin Popullor, dhe e shpallën pavarësisë e Shqipërisë, dhe zgjodhën qeveri të përkohshme. Shqiptarët janë të lumtur që do t'i bashkëngjiten familjes së popujve të lirë të Evropës lindore, duke mos pasur qëllim tjetër përveç se të jetojnë në paqe me të gjithë fqinjët e tyre. Me shpresën që qeveritë tuaja mbretërore do ta pranojnë këtë ndryshim në jetën kombëtare të shqiptarëve dhe qeverisë tonë të përkohshme; që secili aksion armiqësor i ushtrive tuaja brenda kufijve tanë do të ndërpritet, dhe që të gjitha territoret shqiptare që tani i okupojnë forcat tuaja sërish do të çlirohen.

Qeveria e Përkohëshme e Vlorës…, pp.42-43.

Burimi **1**

Për kryengritjen e Ohrit – Dibrës shkruan në biografinë e vet shkrimtari nga Struga, Risto Krle

Në fshatrat Rajcë dhe Prenjas në Shqipëri në afërsi të kufirit me Maqedoninë, përballë maleve Jabllanica, u mblodhën shumë refugjatë shqiptarë dhe maqedonas, duke përfshirë dhe Millan Matovin, nënkryetarin e qeverisë së Shqipërisë Esad Pasha, ish gjeneral i sulltanit, dhe shumë të tjerë. Atyre iu ofrua mikpritje e madhe. Refugjatët maqedonas dhe shqiptarë formuan secili shtabin e tyre. Qëllimi i tyre ishte çlirimi i Maqedonisë dhe marrja e përbashkët e pushtetit nga duart e tyre. Komanda e përbashkët e kryengritësve maqedono-shqiptarë ishte në fshatin Rajcë.

P K , A , C , 1990, str. 164

Burimi **2**

Kryengritja e Tikveshit

Kryengritja e Tikveshit ishte rezistenca e parë masive e armatosur e popullsisë kundër pushtetit serb i cili e okupoi Maqedoninë e vardarit pas tërheqjes së turqve në Luftën e Parë Ballkanike. Kryengritja filloi në Tikvesh më 19 qershor 1913 dhe zgjati 7 ditë. Kryengritja e Tikveshit është rezultat e organizimit spontan të banorëve të Tikveshit nën drejtimin e aktivistëve lokalë, revolucionarëve dhe princërve, me përkrahjen e forcave të VMRO-s.

B A H Ж , "П

Burimi **3**

Qeverive dhe publikut të vendeve të Lidhjes Ballkanike

Maqedonasit vazhdimisht, gjatë shekujve ngrinin krye dhe luftonin për pavarësi dhe liri, dhe me luftën e tyre këmbëngulëse ndihmuan në çlirimin e Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë... Më tepër se njëqind mijë luftëtarë maqedonas luftuan krah për krahu me ushtarët e Aleancës...
Në vend të Maqedonisë, e bërë e famshme nga Aleksandri i Maqedonisë, e bekuar nga apostulli Pavle, krenare për punën e dy vëllezërve Kirilit dhe Metodiut... në vend të bashkimit, Maqedonisë së tërësishme dhe të lirë, diplomacia evropiane, dhe të edhe ju, vëllezër tanë, aleatë dhe çlirimtarë, na ndani në copëza dhe i nëpërkëmbni idealet tona të shenjta... Mbajeni mend, vëllezër Bullgarë, Serbë dhe Grekë, që lindët sërish që të filloni jetë të re pas 14 luftërave të përgjakshme të Rusisë kundër Perandorisë Osmane... Mbajeni mend që Maqedonia e përçarë do të jetë përgjithmonë mollë sherri mes jush. Kujtohuni që gjatë historisë, në të kaluarën, u zhdukën shtetet njëri pas tjetrit në luftë për Maqedoninë, andaj mos e vazhdoni atë listë të përgjakshme të të vdekurve në këtë kohë... Maqedonia duhet të jetë shtet i pavarur në kufijtë e saj etnografikë, gjeografikë, kulturorë dhe historikë, me qeveri e cila i përgjigjet Kuvendit Popullor...
Trupi i përfaqësimit kombëtar duhet të formohet në Selanik, me anë të zgjedhjeve të përgjithshme. Vëllezër aleatë dhe çlirimtarë! Shpresojmë që fjalët tona do të arrijnë deri te zemrat tuaja dhe vetëdija e juaj.

Shën Petërzburg, nënshkruar nga
përfaqësuesit e autorizuar.
Marë nga Makedonskii Golos, St. Petersburg, f. 52-55.

Burimi **4**

Ideja për Maqedoninë autonome, kontestohet nga ana e gazetarit francez. Gusht 1912

"A do ta zbatojmë këtë rrjedhë të ngjarjeve, ndaj autonomisë së Maqedonisë? Ideja "Maqedonia maqedonasve" u zhvillua gjatë disa viteve të kaluara dhe rrezikon ta zëvendësojë idenë e copëtimit të rrezikshëm të Maqedonisë dhe ndarjeve mes shteteve të ndryshme ballkanike. Por të gjitha dridhjet të cilat vazhdimisht e shqetësojnë këtë zonë siç duket vijnë nga lëvizja bullgare, sesa nga lëvizja maqedonase. Në kushtet e tanishme, do të ishte e vështirë të organizohet autonomia maqedonase pa favorizim të konsiderueshëm të anës bullgare, duke i viktimizuar interesat e popujve të tjerë. Kjo do të provokonte rezistencë të dëshpëruar në vet zemrën e Maqedonisë. Në fund, nuk duhet të harrojmë që grekët dhe karavllehtë (rumunët) e Maqedonisë, nga frika e hegjemonisë të elementëve sllavë, janë për status kuo.

AlbeÅLric Cahuet, "La situation en Turquie et la proposition Berchtold", L'Illustration, 3626, 24 aou^t 1912, str. 123.

Burimi **5**

Autoritetet serbe, jo vetëm në Ohër por edhe më gjerësisht në Maqedoninë Perëndimore janë të informuar se por bëhen përgatitje për kryengritje në regjion. Për këto përgatitje Mirko Novakoviq, kryeshefi i shtabit të qarkut të Manastirit, me anë të telegramit e informon ministrin e punëve të brendshme në Beograd.

"Kryeshefi i regjionit të Prespës thotë se janë shfaqur banda anarkiste nën udhëheqjen e Petar Çaulevit dhe Krste Trajçevit, udhëheqës bullgarë, me çetnikët e tyre, dhe përbëjnë kërcënim më të madh sesa arnautët. Në rast të sulmit të tyre do të ngriten fshatrat dhe qytetet, dhe çdo gjë është gati.

П. M , C - (1890–1940) C , 2002, . 182, ..

Aktiviteti 4

Renditi dokumentet!

Dokumente për të gjitha grupet!

Cilat janë pasojat e luftës?
Nxënësit do t'i analizojnë dokumentet dhe atëherë do të përcaktojnë cili term ku bënë pjesë dhe pse. Shprehjet janë si vijon:
-**I shquar**
-Që mbahet mend
-Rezulton në ndryshim
-Rezonant
-Që zbulon shumë
Ky diskutim duhet të vazhdojë dhe të ofrojë përgjigje në pyetjen tjetër kyçe. Gjithashtu të përgjigjet në pyetjen: **Pse luftërat ballkanike janë kontroverse dhe të ndjeshme edhe sot!**

Burimi **1**

Statistika e luftërave ballanike

	Sipërfaqja më milje në katrorë		Popullsia mesatare	
	Para lufte	Pas lufte	Para lufte	Pas lufte
Shqipëria	-	11,317	-	850,000
Bullgaria	33,647	43,310	4,337,516	4,467,006
Greqia	25,014	41,933	2,666,000	4,363,000
Mali i Zi	3,474	5,603	250,000	500,000
Rumania	50,720	53,489	7,230,418	7,516,418
Serbia	18,650	33,891	2,911,701	4,527,992
Turqia në Evropë	65,350	10,882	6,130,200	1,891,000

Burimi **2**

Kartolinë serbe nga Luftërat Ballkanike



"Përshëndetje nga bregdeti serb. Durrës. Suvenir nga limani i parë serb."

http://sh.wikipedia.org/wiki/Datoteka:Pozdrav_sa_srpskog_primorja.jpg

Burimi **3**

Tërheqja e trupave të mundura osmane

http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Ottoman_soldiers_after_the_First_Balkan_War.png

Burimi **4**

Varr në fshat afër Manastirit, Maqedoni

Këtu prehet
Liskovski Petko
1882 – 1970
Ushtar turk 1910 – 1912
Ushtar serb 1914 – 1915
Ushtar bullgar 1916 – 1918
Dhuratë e fundit nga nipërit
Hristo, Krste dhe Mishko

http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/102400-bitola-nagradata-mende-petkovski-za-novinarkata-zaneta-zdravkovska

Burimi **5**

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë

http://en.wikipedia.org/wiki/File:28nentor.jpg

Burimi **6**

Pllakat i shtypur në Greqi në vitin 1912

http://en.wikipedia.org/wiki/File:New_Greece.jpg

Burimi **7**

Zebrnjak, përmendore e ushtarëve serbë nga Luftërat Ballkanike, Kumanovë, Maqedoni



http://www.va.mod.gov.rs/cms/view.php?id=10479

Burimi **8**

Ndryshimi i tabelave në stacionin hekurudhor në Shkup pas hyrjes së ushtrisë serbe në qytet

http://en.wikipedia.org/wiki/File:Skoplje_1912.jpg

Burimi **9**

Maqedonia e ndarë pas Luftërave Ballkanike



http:// www.kirilica.com.mk/ vest.asp?id=76676